



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë - Ministarstva za Obrazovanje
Nauku i Tehnologiju - Ministry of Education, Science and Technology
Inspektoriati i Arsimit në Republikën e Kosovës

Në bazë të Ligjit Nr. 06/L – 114 për zyrtarët publikë, Neni 38 (1,2,3 dhe 4) dhe Rregullores (QRK) NR. 16/2020 për pranimin dhe karrierën në shërbimin civil të Republikës së Kosovë, Neni 40 Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit-Inspektoriati i Arsimit të Kosovës shpall:

Konkurs

Lëvizje brenda kategorisë

Të drejtë për aplikim në këtë procedure kanë vetëm nëpunësit civil ekzistues të së njëjtës kategori të punësuar në të njëjtin apo në një tjetër institucion të shërbimit civil.

Titulli i pozitës së punës	Udhëheqës i Sektorit për Arsim
Klasa e pozitës	Drejtues i Ulët 2
Koeficienti/Paga	9
Nr. i kërkuar	1
Data e njoftimit	17/06/2021
Afati për aplikim	09/07/2021 - 17/07/2021
Institucioni	Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit-Inspektoriati i Arsimit të Kosovës
Departamenti	SIA në Ferizaj
Divizioni	
Vendi i punës	SIA - Ferizaj
Nr. i Referencës	RN00006994
Kodi	RPC0000860



1. Përshkrimi i përgjithshëm i punës

- Mbështet dhe ofron këshilla për drejtorin e departamentit dhe sipas kërkesës për udhëheqësin më të lartë administrativ të institucionit dhe titullarin e institucionit për fushën e përgjegjësisë së divizionit që udhëheqë;
- Drejton dhe mbikëqyr të gjitha aktivitetet e divizionit dhe siguron funksionim efikas të tij, si dhe ndihmon Drejtorin në caktimin e objektivave dhe zhvillimin e planit të punës për përmbushjen e këtyre objektivave;
- Kontribuon në procesin e vendimmarrjes, sipas fushës së përgjegjësisë, duke siguruar të dhëna të detajuara dhe analizave të cilat mbështesin procesin e vendimmarrjes;
- Planifikon, përgatit, monitoron dhe analizon buxhetin e divizionit si dhe aktivitetet tjera të divizionit dhe siguron përmbushjen e tyre sipas planit;
- Organizon dhe shpërndan punën për stafin të tij/saj dhe menaxhon realizimin e detyrave dhe përgjegjësisë që duhen përmbushur në përputhje me objektivat dhe përgjegjësitë e divizionit;
- Të vlerësojë përparimin dhe cilësinë e zbatimit të kurrikulës, aspektin pedagogjik të mësimdhënies dhe të vlerësimit, realizimin e Planit Individual të Arsimit (PIA) për fëmijët me aftësi të kufizuara;
- Të vlerësojë materialet dhe mjetet e konkretizimit për mësimdhënie dhe të nxënë dhe përdorimi i tyre i përshtatshëm;
- Të rekomandojë masa për përmirësim, duke përfshirë trajnimin për mësimdhënës, ndryshimet në qasjet pedagogjike, organizimin e ndryshëm të orëve, orët plotësuesenë lëndë të caktuara;

2. Kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e veçanta

- Të jetë nëpunës civilë i të njëjtës kategori për të cilën aplikon.
- Të mos jetë ndëshkuar me ndonjë masë disiplinore që nuk është shuar ende.
- Të jetë vlerësuar të paktën 'mire' për rezultatet në punë, të paktën gjatë dy viteve të fundit të vlerësimit.

3. Kërkesat e përgjithshme formale

- Kualifikime të posaçme profesionale;
- Diplomë universitare të studimeve themelore dhe postdiplomike 300 kredi/ ECTS, (MA, MSC, MR) në fushën e arsimit dhe juridike;
- Përvoja e punës e kërkuar:..Së paku dhjetë 10 vite përvojë pune në fushën arsimore dhe juridike;
- Të mos këtë ushtruar funksione politike në tre (3) vitet e fundit.
- Të mos jetë i dënuar;
- Të ketë të paktën pesë (5) vite përvojë pune si inspektor i arsimit.

4. Kërkesat (Njohuri, Aftësi dhe Cilësi) e përgjithshme të nevojshme

- Njohuri të gjera e të thella të politikave, legjislacionit, procedurave sipas veprimtarisë që mbulon divizioni;
- Aftësi organizative dhe drejtuese për të menaxhuar njësi organizative ;
- Aftësi për t'iu përshtatur prioriteteve dhe kërkesave, afateve kohore përmes aftësive analitike dhe zgjidhjes së problemeve;
- Aftësi komunikimi dhe ndikim personal, përfshirë aftësinë për të krijuar dhe mbajtur marrëdhënie besimi me eprorin dhe stafin që e menaxhon;
- Aftësi për të motivuar stafin dhe për të menaxhuar me sukses një sërë projektesh të divizionit.



5. Dokumentacioni që duhet paraqitur për aplikim

- Kopjet e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore
- Kopjet e dëshmisë së punësimit
- Kopjet e dëshmisë së trajnimeve
- Kopje të vlerësimeve të punës për dy vitet e fundit
- Dokument që dëshmon se nuk keni ndonjë masë disiplinore që nuk është shuar ende;
- Dëshmi që nuk është nën hetime;

6. Data e daljes së rezultateve të vlerësimit paraprak

- Lista e kandidatëve të cilët plotësojnë kushtet për lëvizje brenda kategorisë do të shpallet më së largu deri më datën 24/07/2021, në portalin e rekrutimit elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

7. Data, vendi dhe ora ku do të zhvillohet intervista me gojë

- 21/07/2021, vendi MASHTI Prishtinë, ora 10.40

8. Fusha e njohurive, aftësive dhe cilësive që do të vlerësohen në intervistën me gojë

- Njohuri dhe përvojë në fushën e edukimit dhe arsimimit dhe mbikëqyrjes së zbatimit të ligjshmërisë;
- Njohuri të ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme lidhur me arsimin
- Shkathtësi në komunikim planifikim të punës dhe udhëheqje të ekipit;
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave;
- Aftësi për përmbushje të detyrave dhe punëve nën presion;
- Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Power Point, Internetit).

9. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve

- Intervist

10. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët

- Përmes email dhe portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

11. Mënyra e aplikimit

- Përmes portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

12. Data e shpalljes së rezultateve përfundimtare

- Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, fituesi do të shpallet përmes portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>). Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike.

Komunitetet joshumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në shërbimin civil të Kosovës, siç specifikohet në Ligj.

Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre, gjinia më pak e përfaqësuar dhe personat me aftësi të kufizuara inkurajohet të aplikojë për pozitat e shpallura.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen



